



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT
KËSHILLI BASHKIAK BERAT
Komisoni i Përhershëm për Ekonominë, Financën dhe Shërbimet Sociale

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: “MBI PËRDORIMIN E GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCE
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “ MOBILIM I PARKUT TEK BIBLIOTEKA E
QYTETIT

Analiza ligjore: (bazueshmëria ligjore)

Propozimi mbështetur në ligjin Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin plotësues nr. 2 datë 14.01.2026 të Ministrit të Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2026”, Udhëzimin e Përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Pushtetit Vendor nr. 1031/5 datë 11.07.2025 dhe nr. 10725 datë 11.07.2025 “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025”, Njoftimin e Ministrisë së Financave për shpalljen fituese të Bashkisë Berat me shkresën e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore nr. 764 datë prot. datë 19.12.2025., Detajimin e Fondit të Grantit të Bazuar në Performancë për bashkitë për vitin 2025, me burim financimi nga buxheti i shtetit , me shkresë të Ministrisë së Financave nr. 18133/1 prot. datë 24.12.2025 e regjistruar në institucionin tonë nr. 7446 prot, datë 30.12.2025”

Situata aktuale e funksionit(përshkrim i situatës së shërbimit / funksionit)

Granti i Bazuar në Performancë është një formë financimi shtesë për bashkitë në Shqipëri, e cila jepet në mënyrë konkurruese në varësi të përmbushjes së një grupi treguesish të matshëm të performancës. Qëllimi i këtij granti është të nxisë përmirësimin e qeverisjes vendore, forcimin e kapaciteteve administrative dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

Situata Financiare



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkisë Berat, si vlerësim për performancën financiare dhe administrative, i është miratuar Grant i Bazuar në Performancë në shumën totale **6,029,908.78 lekë**, i ndarë si më poshtë:

- **2,696,629.21 lekë – burim i brendshëm** (akorduar në fund të dhjetorit 2025 dhe i trashëguar në vitin 2026)
- **3,333,279.56 lekë – burim i jashtëm** (akordohet pas dërgimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak në Ministrinë e Financave)

Ky fond përfaqëson një vlerësim konkret për menaxhimin e mirë financiar të Bashkisë dhe është rezultat i përmbushjes së indikatorëve të përcaktuar nga Ministria e Financave.

Miratimi i përdorimit të këtij fondi nga Këshilli Bashkiak është kusht për disbursimin e plotë të tij.

Drejtoria / Sektori përgjegjës

Drejtoria e Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve, Drejtoria Juridike, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.

A është objekt i konsultimit publik:

Ky material nuk është objekt i konsultimit publik

Komisioni i Përhershëm për “ **Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale**” , i mbledhur në datën 27/02/2026, shqyrtoi projekt vendimin “**MBI PËRDORIMIN E GRANTIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “ MOBILIM I PARKUT TEK BIBLIOTEKA E QYTETIT”**

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash

VENDOSI:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

1. Të miratojë përdorimin e fondit prej **6,029,908.78 lekë**, të përfituar nga Granti i Bazuar në Performancë për vitin 2025, për realizimin e investimit:

“Mobilim i Parkut tek Biblioteka e Qytetit”.

Fondi përbëhet nga:

- 2,696,629.21 lekë me burim të brendshëm, të trashëguara në vitin 2025;
- 3,333,279.56 lekë me burim financimi nga financimi i huaj, që detajohen pas paraqitjes së këtij vendimi pranë Ministrisë së Financave.

2. Fondi do të përdoret për realizimin e punimeve si në preventivin bashkëngjitur.

3. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për kryerjen e klasifikimit buxhetor në Programin AB102 “Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile” dhe shtimin e këtij projekti në buxhetin e vitit 2026 të njësisë shpenzuese Bashkia Berat Qendra.

Kod Institucioni	Kap. Fin.	Programi	Produkti	Llog.	Pershkrimi	Vlera Lekë
2102001		Bashkia Berat (Aparati)				6,029,908.77
2102001		AB102	Shërbimet Publike, Infrastruktura & Emergjencat Civile			6,029,908.77
2102001	01	AB102		231	Mobilim i Parkut tek Biblioteka e Qytetit	2,696,629.21
2102001	02	AB102		231	Mobilim i Parkut tek Biblioteka e Qytetit	3,333,279.56
total						6,029,908.77

Komisioni i Përhershëm për Ekonominë,Financën dhe Shërbimet Sociale

Krenar Suku- Kryetar i Komisionit

Anisa Velu –N/Kryetar

Endrina Tangu-Sekretar i Komisionit

Fatjon Elezi-Anëtar

Rovena Cuku-Anëtar



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

Muharem Hoxha-Anëtar

Shyqyri Dura-Anëtar

Datë 27/02/2026